



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve



Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tirane /12/2014

**Relacion**

*Per llogaritjen e tarifave te prodhimit te energjise elektrike, te sherbimit te furnizimit me shumice, transmetimit, shperndarjes dhe shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per vitin 2015.*

**Bordit te Komisionereve**

KESH sh.a, OSTsh.a dhe OSHEE sh.a, kane paraqitur prane ERE-s kerkesat per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te sherbimeve te prodhimit/shitjes me shumice, te transmetimit, te shperndarjes dhe te shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2015, perkatesisht me shkresat Nr. 5689 Prot., date 22.09.2014, OST sh.a., Nr. 7662 Prot., date 31.10.2014, KESH sh.a. , si dhe Nr. 9937/3Prot., date 12.11.2014, OSHEE sh.a.

Tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek çmimet e shitjes me pakice per klientet fundore, dhe per sa percaktuar ne Ligjin nr.9072 date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, dhe neni 26, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave duhet te shqyrtohen njekohesisht pergjate gjithe procesit, qe nga aplikimi i tyre dhe publikimi nga shoqerite perkatese dhe ERE, deri ne miratimin perfundimtar.

Por ajo qe duhet theksuar është se ky rishikim vjen ne kushtet e:

- Pezullimit ne vitet 2013 -2014 te rishikimit te te ardhurave te kërkuara te kompanive publike (KESH sh.a, OST sh.a, OSHEE sh.a) për shkak te operimit në treg i aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë nën statusin e administrimit të përkohshëm. Statusi juridik i kompanisë në administrim të përkohshëm i kompanise se shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice bënte të pamundur vlerësimin e tarifave për këto aktivitete.

- Gjendja tepër e vështirë financiare e trashëguar ne sistemin e energjitik si pasoje e performances se dobet te kompanisë qe ushtronte aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice gjate viteve 2011-2012, e cila u reflektua drejtpersederejti ne aktivitetin e dy operatoreve te tjerë KESH sh.a dhe OST sh.a.
- Paraqitjen ne afate kohore te ndryshme te aplikimeve nga te tre operatoret e per me teper ardhja me vonese e aplikimit te OSHEE sh.a (aplikimi i OSHEE-se eshte me 13.11.2014) zvogëloi ndjeshem kohen ne dispozicion te EREs per shqyrtimin e aplikimeve dhe marjen e vendimit. Rregullat e praktikës dhe procedurave te EREs ne nenin 21 pika 6, percaktojne se : *ERE-ja do te shpallë vendimet mbi përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve brenda 4 muajve nga marrja e vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit.*
- Mos ardhje aplikimi nga hec- Lana Bregas i cili aktualisht operohet nga UKT sh.a. Kujtojmë se se fundmi shoqeria UKT sh.a i eshte nenshtruar nje procesi ndarje sipas Ligjit per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare sipas pasoje e te ciles eshte krijuar shoqeria HEC Lanabregas me objekt operimin e Hec Lanabregas sh.a e cila ka aplikuar per transferimin e licenses se prodhimit dhe tregtimit. Ne kushtet e mungeses se te dhenave nga kompania vleresojmë qe tarifa e prodhimit te energjise elektrike te mbetet e pandryshuar dhe te dhenat ekonomiko financiare te jene objekt kontrolli ne vijim per te bere axhustimet e mundeshme per periudhen tjeter te rregullimit.
- Mos paraqitje aplikmi nga kompania TEC Vlore sh.a si pasoje e mos venies ne operim per shkak te defektit teknik.
- Udhezimeve te MEI, dhe Ministrise se Financave, sipas shkresave nr.7125/3 date 23.12.2014, nr.7125/4 Prot. date 24.12.2014 dhe nr16753/1. Prot. date16.12.2014, ne pergjigje te kërkesave te ERE-s drejtuar Ministrise se Energjise dhe Industrise, Ministrise se Financave, dhe Ministrise se Ekonomise, Siper marrjes dhe Tregtise.
- Raportit te dorezuar nga konsulenti i USAID per ERE-n gjate qendrimit te tij ne periudhen 16-22 Nentor 2014.
- Letres se ardhur nga Autoriteti i Konkurences, Nr.Prot 524 Date 10.12.2014, ne lidhje me aplikimin per cmimet e rregulluara nga te tre kompanite.

Per sa me siper nga drejtorite teknike eshte procerduar ne nje afat kohor shume te shkurter shqyrtymi i aplikimeve per fillim procedure, pyetjet shtese dhe seanca teknike, ne menyre qe te mundesohej marrja e vendimit nga Bordi i Komisionereve te ERE-s brenda muajit Dhjetor .

Sikurse cituar edhe me lart ne mbeshtetje te neneve 26 dhe 27 te Ligjit nr.9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike”, te ndryshuar, dhe te akteve te tjera nenligjore, aplikimet e shoqerive jane shqyrtuar **njekohesisht** nepermjet nje procesi publik dhe tejet transparent, duke ndjekur dhe respektuar procedurat ligjore per shqyrtimin, llogaritjen dhe miratimin perfundimtar te ketyre tarifave, ne perputhje me kuadrin ligjor si dhe me Rregullat dhe Metodologjite e miratuara prej ERE-se.

Ne kete relacion jepen te detajuara analizat perkatese te bera nga ana e Drejtorive Teknike, te te gjitha kerkesave per te ardhura te cdo aktiviteti qe parashikohet te kryhet nga kompanite e licensuara, perfshire proceduren dhe hapat e ndjekura ne gjithe kete proces.

## **1. BAZA LIGJORE DHE PROCEDURA E NDJEKUR PER SHQYRTIMIN E APLIKIMEVE:**

- 1- Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikes dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuar, pasi mori ne shqyrtim aplikimet e paraqitura nga KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE, sh.a, *me Vendimet e Bordit te Komisionereve nr. 90 date 6.10.2014, 99 dhe 100 date 7.11.2014, 110 dhe 111 date 18.11.2014*, vendosi fillimin e procedurave per percaktimin e tarifave respektive te aktiviteteve te energjise elektrike, vendime te cilat jane publikuar ne Fletoren Zyrtare Nr. , 171/2014, 181 /2014 dhe 189/2014.
- 2- Aplikimet e KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a, jane publikuar ne faqen zyrtare te internetit te ERE [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al), ERE ka qene e hapur dhe ka vene ne dispozicion materialet e aplikimeve per te gjitha palet e interesuara.

- 3- Bazuar ne Vendimet e mesiperme per fillimin e procedurave te shqyrtimit te kerkesave per rishikimin e tarifave dhe cmimeve te shitjes se energjise elektrike per vitin 2015, ERE ka pasur nje korrespondence intesive me keto shoqeri, nepermjet te ciles eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me aplikimet e tyre.
- 4- Ne mbeshtetje te Rregullave te Praktikave dhe Procedurave, konkretisht te neneve 29 dhe 31 pika 1 dhe 2, te miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr.21, date 18.03.2009, te ndryshuar, nga data 14-17 Nentor 2014 midis perfaqesuesve te ERE-s dhe perfaqesuesve te KESH sh.a./FPSH, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., jane zhvilluar seanca degjimore teknike lidhur me shqyrtimin e aplikimeve perkatese te shoqerive per tarifate e enegjise elektrike per vitin 2015.
- 5- Ne daten 05.12.2014, ERE, organizoi seancen zyrtare publike, ne te cilen u ftuan te merrnin pjese per te diskutuar dhe shprehur qendrimet dhe opinionet e tyre lidhur me keto aplikime te gjitha institucionet, shoqatat e mbrojtjes se konsumatoreve, si dhe te gjitha palet e tjera te interesuara dhe perfaqesues te publikut te gjere, nepermjet njoftimit i cili u publikua nga ERE ne median e shkruar dhe ate vizive. Mendimet e paleve te shprehura ne kete seance u shqyrtuan nga drejtorite teknike te ERE-s ku nga analiza e kerkesave te shprehura nga palet e treta ne seance veren se:

Pyetjet dhe komentet e pjeses me te madhe te paleve te interesuara ishin te nje karakteri te pergjithshem duke kerkuar te mos lejohet nje rritje abuzive dhe e paargumentuar e cmimeve te energjise elektrike, i cili do te rendonte padrejtesisht konsumatoret e rregullt familjare.

Pas realizimit te ketij procesi transparent, drejtorite teknike per hartimin e ketij relacioni per percaktimin e te ardhurave te kerkuara vetem per vitin 2015 jane bazuar ne parimet e percaktuara ne vendimet si me poshte:

- Vendimin nr. 77, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per kompanine publike te gjenerimit te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 78, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me shumice te energjise elektrike”;

- Vendimin nr. 59, date 29.12.2005, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes se transmetimit te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 79, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes te tarifes se shperndarjes te energjise elektrike”;
- Vendimin nr. 80, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s, “Per miratimin e metodologjise se llogaritjes se tarifes per furnizuesin publik me pakice te energjise elektrike”.

Duke patur parasysh parimet e percaktuara ne aktet nenligjore te mesiperme dhe sikurse theksuar edhe me lart duke qene se tarifat e sherbimeve te energjise elektrike jane te transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice per konsumatoret fundore, kerkesat e paraqitura per rishikimin e ketyre tarifave nga te tre shoqerite, u shqyrtuan njekohesisht pergjate gjithe procesit te ndjekur nga ERE.

Gjithashtu duhet theksuar se ERE ka llogaritur cmimet perkatese per cdo kompani duke u bazuar tek metodologjite perkatese por duke mos marre parasysh vetem axhustimet e periudhes 2012-2014 gje qe behet e pamundur te zbatohet ne situaten aktuale per shkak te detyrimeve te ndersjellta te paleve ne shifra te konsiderueshme. Keto detyrime, ashtu sikurse shprehur nga MEI ne letren e derguar, do te jene subjekt i nje iniciative ligjore ne fillim te vitit 2015 per strukturimin e tyre. Gjithashtu ky veprim i EREs eshte mbeshtetur edhe ne opinionin e konsulentit te USAID-it te dhene EREs.

## **2. TARIFAT PER KESH SH.A. NE FUNKSONET E *PRODHIMIT DHE FURNIZIMIT ME SHUMICE TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER VITIN 2015.***

### **2.1. TARIFA E *PRODHIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE PER VITIN 2015.***

Llogaritja e tarifes te prodhimit te energjise elektrike eshte bazuar ne metodologjine perkatese te miratuar nga ERE dhe eshte mbeshtetur ne analizen e

kerkesave per te ardhura te paraqitur ne aplikimin e KESH sh. a. te dates 31.10.2014 dhe e korrigjuar me pas te dates 22.12.2014.

Ashtu sikurse eshte permendur me larte ne kete relacion ERE nuk po ben axhustim te te ardhurave per periudhen 2012-2014 qe kane lidhje me; te ardhurat e realizuara nga prodhimi i energjise me teper se ai i parashikuar ne tarife, mosrealizimi i investimeve te parashikuara si pasoje e gjendjes se veshtire financiare etj. Cmimi i percaktuar per vitin 2015 per kete kompani eshte bazuar vetem ne kostot dhe shpenzimet e kerkuara per kete vit.

KESH parashikon ne aplikimin e tij qe prodhimi bruto i energjise elektrike per vitin 2015 te jete 3,460 GWh. Kete parashikim kompania e ka bazuar mbi treguesit mujore te prodhimit per vitin 2015 nisur nga nje parashikim i prurjeve te rendit me 75% siguri. Ky parashikim lidhet gjithashtu edhe me shfrytëzimin optimal te burimeve hidrike ne menyre qe te sigurohet mbajtja e nivelit optimal te liqenit te Fierzes si dhe ruajtja e rezerves energjitike ne fund te vitit. Nderkohe, ne planifikimin e prodhimit eshte marre ne konsiderate fakti qe HEC Koman planifikohet te jete ne faze rehabilitimi gjate vitit 2015 e per rrjedhim do te operoje me nje agregat me pak. Tabela ne vijim paraqet parashikimin e prodhimit (MWh) per vitin 2015 per te tre njesite prodhuese:

Njësia	Parashikim i Prodhimit
	Viti 2015
HEC Fierzë	1,099,430
HEC Koman	1,543,071
HEC Vau i Dejës	817,525
<b>Totali 2015</b>	<b>3,460,026</b>

Ne vijim po paraqesim kerkesen per te ardhura nga Shoqeria Publike e Gjenerimit per vitin 2015 si dhe axhustimet e bera pergjate analizes nga ana e EREs.

**Tabela:Struktura e kostove dhe tarifa perkatese per KESH Gen(milion leke):**

	Aplikuar nga KESH Gen	Propozimi ERE
Zeri	2015	2015
Mirembajtje	216	216
Personeli	973	973
Furnitura e Sherbime	560	560
<b>Totali OPEX</b>	<b>1,749</b>	<b>1,749</b>
Vlera e aseteve	32,679	32,683
Amortizimi I akumuluar	8,474	8,628
<b>Vlera neto e Aseteve</b>	<b>24,205</b>	<b>24,055</b>
Kapitali I Punes	437	437
Investime	6,053	5046
Amortizimi I Vitit	1,026	1026
<b>Baza e Rregulluar e Aseteve( RAB)</b>	<b>26,643</b>	<b>28,512</b>
Kthimi I Lejuar mbi Kapitalin pas Taksave	3.46%	3.46%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40.00%	40%
Kosto Mesatare e borxhit	1.72%	1.71%
Raporti I Synuar I Borxhit	60.00%	60%
WACC	2.41%	2.41%
Fitimi	643	687
te ardhura nga interesat		
kosto fikse/sherbi I borxhit TEC Vlore	1,523	1531
<b>Te ardhurat e Kerkuara</b>	<b>4,941</b>	<b>4,993</b>
Eksport I energjise Elektrike axhustim I te ardhurave per vitin 2011,2012		
Te ardhurat e kerkuara minus Eksportin	4,941	4,993
<b>Te ardhurat e Kerkuara Neto</b>	<b>4,941</b>	<b>4,993</b>
Energjia e Prodhuar	3,433	3,433
<b>Tarifa Mesatare e Prodhimit</b>	<b>1.44</b>	<b>1.45</b>

Ne vijim po paraqesim me te detajuar kerkesat e KESH Gen per te gjitha zerat e kostove.

### 2.1.1. Shpenzimet Operative (OPEX)

KESH sh.a. propozon qe shpenzimet opertive per vitin 2015 te jene ne total 1,749 milion leke.Tabela ne vijim paraqet ne menyre te permblledhur ecurine e elementeve te shpenzimeve operative gjate periudhes 2012-2014 si dhe

propozimin per vitin 2015, krahasuar me aprovimin e ERE-s dhe me realizimin faktik:

( milionë lekë)

Nr.	Përmbajtja	Miratimi ERE (2012-2014) - mesatare	Aplikimi nga KESH-Gen për vitin 2015					Realizimi I pritshem I krahasuar me miratimin e ERE-s 2012-2014	Aplikimi 2015 krahasuar me realizimin faktik 2012-2014	Aplikimi 2015 krahasuar me miratimin e ERE 2012-2014	Për t'iu Propozuar Bordit për miratim
			2012 (Fakt)	2013 (Fakt)	2014 (Program)	2012-2014 (mesatare)	2015 (Aplikim)				
a	b	1	2	3	4	5	6			7	
1	Mirembajtje	211	79	83	170	111	216				216
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme	1,047		5%	105%	-48%	27%	-48%	95%	2.4%	
2	Personeli	1,047	742	805	860	802	973				973
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			8%	7%	-23%	13%	-23%	21%	-7.1%	
3	Furnitura dhe sherbime	717	762	1,280	515	852	560				560
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			68%	-60%	19%	9%	19%	-34%	-22%	
I	Σ OPEX	1,975	1,583	2,168	1,545	1,765	1,749				1,749
	Rritja në % kundrejt vitit të mëparshëm			37%	-29%	-11%	13%	-11%	-1%	-11%	

## Shpenzimet per mirembajtje

ERE, per periudhen 2012-2014 aprovoi nje nivel mesatar vjetor te shpenzimeve per mirembajtje prej 211 milion leke mbeshtetur ne te dhenat historike per periudhen 2008-2011. Gjate periudhes 2012-2014, realizimi i ketij shpenzimi ka qene me i ulet nga parashikimi (mesatarisht 111 milion leke ne vit) si rrjedhoje e situates se veshtire financiarete shkaktuar nga mosarketimi i faturave te shitjes se energjise elektrike (arketimi per faturat e viteve 2013 dhe 2014 ka qene respektivisht ne nivelet 30% dhe 49.5%). Ne aplikimin e tij KESH Gen ka kerkuar qe shpenzimet per mirembajtje ne vitin 2015 te jene 216 milion leke. Kjo kerkese mbeshtetet ne faktin qe per me shume se tre vjet ka munguar mirembajtja sipas planifikimit te mbeshtetur ne normat teknike, gje qe ka rritur nevojën per shpenzimet per mirembajtje per vitin 2015. Megjithate duhet theksuar se kerkesa e kompanise per shpenzime per mirembajtje perben nje rritje vetem 2.4 % krahasuar me mesataren vjetore te aprovuar nga ERE per periudhen 2012-2014.

Per keto arsye kete kerkese te kompanise e kemi konsideruar si te arsyeshme.



## Shpenzimet per paga

Shpenzime per pagat per vitin 2015 ne aplikimin e dates 31.10.2014 nga ana e Shoqerise jane kerkuar ne shumen 973 milion leke. Kjo kerkese eshte rreth 13% me e madhe nga realizimi i vitit 2014 dhe nderkohe rreth 7% me pak nga mesatarja vjetore e aprovuar nga ERE per periudhen 2012-2014.

Kjo kerkese e kompanise argumentohet me faktin qe shoqeria po kalon ne nje proces transformimi i cili ben te nevojshem rikonceptimin e menaxhimit te burimeve njerezore me synimin rritjen e nivelit profesional te punonjesve. Si rezultat i ketij procesi, numri i punonjesve te KESH sh.a. se bashku me shoqerite e kontrolluara prej saj u reduktua nga 1,054 ne 996 punonjes. Nderkohe, ne parashikimin e shpenzimeve per paga eshte marre mare parasysh edhe indeksimi vjetor i pagave per inflacion

Ne pergjigje te kerkeses se ERE-s per paraqitjen e studimit ne lidhje me burimet njerezore, KESH shprehet se po shqyrton mundesine e kontraktimit te nje shoqerie nderkombetare te specializuar per kete qellim.

Pasqyra ne vijim paraqet ndryshimin ne pagen mesatare si rezultat i rikonceptimin e menaxhimit te burimeve njerezore:

	2014		2015		Ndryshimi ne %
	Numri i punonjësve	Paga mesatare (Leke)	Numri i punonjësve	Paga mesatare (Leke)	
HEC Fierza	153	46,159	155	48,735	6%
HEC Koman	146	49,221	148	53,187	8%
HEC Vau Dejës	144	47,340	150	51,136	8%
Aparati KESH	227	77,187	232	87,653	14%
<b>Total KESH</b>	<b>670</b>	<b>57,593</b>	<b>685</b>	<b>63,404</b>	<b>10%</b>

Bazuar ne analizen e numrit te punonjesve dhe fondit te pagave si me lart konkludojme se, fondi i pagave i njohur per vitin 2015 prej 973 milion leke *realisht perfaqeson nevojat e kompanise per kete ze te OPEX-it.*

## “Furnitura dhe sherbime”,

Lidhur me zerin e shpenzimeve “*Furnitura dhe sherbime*” Shoqeria, ne kerkesen per te ardhura ka kerkuar nje shume prej 560 milion lekesh. Kjo kerkese eshte rreth 27% me i ulet nga mesatarja vjetore e miratuar nga ERE per periudhen 2012-2014 per kete shpenzim. Nderkohe veme ne dukje se, per shkak te veshtiresive financiare, realizimi i pritshem per vitin 2014 eshte teper i ulet krahasuar me miratimin, rreth 515 milion leke.

	2012	2013	2014	Parashikim 2015
<b>Materiale ndihmese</b>	25	11	69	95
<b>Shpenzime te tjera</b>	743	1275	446	560
<b>Totali</b>	768	1286	515	655

Pas verifikimit te ketij shpenzimi si dhe shpjegimeve te bera nga Shoqeria gjate seancave teknike te organizuara nga ana e ERE-s, Grupi i Punes eshte i mendimit qe ky ze per vitin 2015 te pranohet ne vleren prej 560 milion leke.

## 2.1.2. Shpenzimet Kapitale (CAPEX)

### Amortizimi

*Amortizimi* - eshte llogaritur nga KESH/GEN duke perdorur normat fiskale te amortizimit, sic dhe parashikohet ne metodologjine e llogaritjes se tarifes se prodhimit te energjise elektrike. Sipas Aplikimit te rishikuar te datese 22.12.2014 ky shpenzim eshte llogaritur nga KESH ne vleren 1,026 milion leke per vitin 2015.

Vlera e realizuar e amortizimit mesatar vjetor per periudhen 2012-2014 eshte rreth 4% me e ulet nga ajo e miratuar nga ERE per te njejten periudhe. Ky rezultat ndikohet drejtperdrejt nga kosto historike e aktiveve si dhe niveli i ulet (46.4 %) i realizimit te investimeve per periudhen e meparshme rregullatore 2012-2014.

Duke marre ne konsiderate shtimin prej 6,053 milione leke te aseteteve te reja per vitin 2015, gjykojme qe te ardhurat per mbulimin e koston se amortizimit te propozuara nga kompania jane te arsyeshme.

### Kthimi mbi bazen e rregulluar te aseteteve

Ne llogaritjen e Bazes se Rregulluar te Aseteve (RAB) per shumen 28,512 milion leke per vitin 2015, jane perfshire:

- Kosto historike e aktiveve afatgjata ne perdorim deri ne 2013, shtesat e aktiveve per 4,039 milione leke qe kompania parashikon te kapitalizojte gjate vitit 2014, vleren e investimeve prej 6,053 milion leke per asetet e reja sipas planit te aprovuar te investimeve per vitin 2015.

- **Kosto e kapitalit (WACC)** është llogaritur sipas metodologjise dhe rezulton 2.41 % per vitin 2015.

Per percaktimin e kthimit mbi kapitalin është marre ne konsiderate ecuria normave te interesit per bonot e thesarit nga ankandet e zhvilluara deri ne fund te vitit 2014 dhe te publikuara ne faqen zyrtare te internetit te bankes se Shqiperise [www. Banofalbania.org](http://www.Banofalbania.org). Norma mesatare e bonove te thesarit parashikohet te jete 3.46%.

Kosto mesatare e borxhit per kontratat e kredive afatgjata te KESH, nisur nga informacioni i vene ne dispozicion per kete qellim, rezulton te jete 1.71 % per vitin 2015.

Nisur nga vlera e koston se kapitalit e percaktuar si me lart, rezulton nje kthim mbi asetin baze te rregulluar ne vlerë absolute e barabarte me vleren 687 milion leke per vitin 2015, nga 643 milion leke propozuar nga shoqeria.

- Kapitali i punes, ndryshe nga praktika e deritanishme, është kerkuar nga shoqeria te llogaritet me  $\frac{1}{4}$  e OPEX-it vjetor. Neni 7.6 i metodologjise se llogaritjes se tarifave per kompanine publike te prodhimit percakton se, per te justifikuar nivelin e propozuar te kapitalit te punes kompania duhet te paraqesi nje studim ose ne te kundert kompania publike e prodhimit mund te jape nje vleresim te nivelit te lejuar te kapitalit te punes me evidenca te shkruara qe justifikojne kete vleresim. Per kete qellim kompania ka paraqitur informacion te detajuar mbi ritmin e shlyerjes se faturave te shitjes se energjise per mbulimin e kerkeses per klientet tarifore. Nga shqyrtimi i informacionit te vene ne dispozicion vertetohet se kompania ka pasur ritem te ulet te shlyerjes se faturave gjate periudhes se kaluar rregullatore. Kjo ka shkaktuar mungese te likuiditeteve efektet e se ciles duhet te eliminohen gradualisht edhe ne vazhdim. Per kete arsye, propozojme qe te pranohet kjo kerkese e kompanise duke rezultuar keshtu ne nje vlerë per kapitalin e punes prej 437 milion leke per vitin 2015.

### 2.1.3. Sherbimi i borxhit per TEC-Vlore

Per sa i takon TEC Vlore, ndajme te njejtin mendim me Ministrine e Energjise dhe Industrise, e cila ne shkresen nr 7125/3 Prot date 23.12.2014 është shprehur qe

ky objekt te konsiderohet si pjese e portofolit te gjenerimit publik e per rrjedhoje edhe kostot fikse te sherbimit te borxhit, te perfshihen ne tarifen e gjenerimit.

Per sa me lart, ne totalin e te ardhurave te kerkuara per aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike perfshihet gjithashtu edhe kosto per sherbimin e borxhit te kredive te marra nga Banka Boterore, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim dhe Banka Europiane per investimin per ndertimin e TEC-it Vlore. KESHsh.a. ne aplikimin e tij parashikon qe shpenzimi per shlyerjen e principalit dhe interesit te kredise per vitin 2015 te jete 1,531 milion leke. Nga shqyrtimi i informacionit per kete qellim konstatojme qe pagesa e principalit te kredive per vitin 2015 parashikohet te jete 1,199 milion leke ndersa interesi i llogaritur eshte 332 milion leke. Propozojme qe ky shpenzim per vitin 2015 te pranohet ne vleren e perlllogaritur prej 1,531 milion leke me kusht qe te behet korrigjimi per diferencen me vleren reale te realizuar te ketij shpenzimi ne te ardhurat per periudhen pasardhese rregullatore.

Per sa me siper spjeguar, te ardhurat totale te kerkuara per te mbuluar shpenzimet OPEX-it dhe CAPEX –it per vitin 2015, sic paraqiten dhe ne tabelen me siper, llogariten ne shumen 4,993 milion leke.

Duke konsideruar qe energjia e parashikuar per tu prodhuar per vitin 2015 eshte 3,433 GWh, rezulton nje tarife mesatare e prodhimit te energjise elektrike prej 1.45 leke /kWh.

Tarifa mesatare e gjenerimit publik te KESH sh.a. e propozuar si me lart do te mundesoje nje situatë financiare normale per realizimin e aktivitetit dhe arritjen e objektivave ekonomike nga ana e Shoqerise Publike te Prodhimit (KESH Gen).

Energjia e planifikuar per t'u shitur tek Furnizuesi Publik me Shumice dhe energjia e planifikuar per t'u shitur per humbjet tek Operatori i Sistemit te Transmetimit, do te realizohen sipas kesaj tarife.

## **2.2. LLOGARITJA E TARIFES MESATARE PER SHERBIMET NDIHMESE**

KESH sh.a. paraqet ne kete aplikim per here te pare kerkesen per tarifen e sherbimeve ndihmese te cilat perfaqesojne sherbime te kontrollit te kapaciteteve gjeneruese ne kohe reale qe sistemi i perdor per te ruajtur balancen e kerkuar ndermjet ngarkeses dhe prodhimit te pergjithshem. Kerkesen per tarifen e sherbimeve ndihmese kompania e parashton si te nevojshme per arsye te riorganizimit te sistemit.

Ne aplikim propozohet nje menyre per llogaritjen e ketij lloj sherbimi ne menyre te mesatarizuar si vijon:

Ne llogaritjen e tarifës mesatare për shërbimet ndihmëse përfshihen:

- Baza e Rregulluar e Aktiveve
- WACC – kosto mesatare e ponderuar e kapitalit
- Amortizimi i vitit
- Pjesa përkatëse e alokuar nga OPEX–i vjetor

Kapaciteti disponibël mesatar vjetor i KESH Gen është 1,250 MW

Kosto e kapacitetit të disponueshëm (lekë/MW) =  $(WACC * RAB + Amortizimi\ i\ vitit + x\ \% * OPEX) / Kapacitetin\ mesatar\ disponibël\ vjetor.$

Kapaciteti disponibel prej 86 MW perben ne fakt kerkesen e OST sh.a. per sigurimin e kapacitetit rezerve te sinkronizuar. Ne llogaritjet ne vijim KESH nuk ka perfshire ndonje alokim te OPEX ne llogaritjen e koston per kapacitetin disponibel.

Llogaritja e tarifës mesatare për shërbimet ndihmëse		
Shpenzimet kapitale	(lekë)	1,726,913,023
Kapaciteti i instaluar disponibel	MW	1,250
Kosto kapaciteti/MW	(lekë/MW)	1,381,530
Kapaciteti rezerve i kerkuar	MW	86
Te ardhurat e kerkuara	(lekë)	118,811,616
Tarifa per MWh	(lekë/MWh)	158

Ne llogaritjet e per koston e gjenerimit sikurse u tregua ne kapitullin perkates te ketij, relacioni shpenzimet kapitale rezultojne pothuaj njesoj 1,728 milion leke. Per pasoje, rezulton e nejta tarife mesatare per shërbimet ndihmëse per 158 leke /MWh.

Kjo tarife e propozuar nga kompania prej 158 leke/MWh, megjithese nuk kemi konfirmimin e OST duket e arsyeshme, prandaj propozojme miratimin e kesaj tarife

per periudhen 2015. Gjithsesi mendojme qe te rishikohet midis paleve saktesia e llogaritjes dhe testimi i aplikimit te kesaj tarife brenda tremujorit te pare te vitit 2015.

Te ardhurat nga sherbimet ndihmese konsiderohen sit e ardhura shtese per kompanine per arsye se nuk jane zbritur nga te ardhurat e kerkuara per prodhimin e energjise elektrike per pasoje do te axhustohen per vleren e realizuar ne periudhen pasardhese.

### **2.3. TARIFA E SHERBIMIT TE SHITJES ME SHUMICE TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FPSH PER VITIN 2015**

Ashtu sikurse kemi sqaruar me lart, perllogaritjet e tarifes nga ana e Furnizuesit Publik me Shumice (FPSH-se) jane bere duke marre ne konsiderate kerkesat per te ardhura per zhvillimin e nje aktiviteti normal per vitin 2015 pa konsideruar te gjitha axhustimet e mundeshme per periudhen regullatore 2012-2014. Mosmarrja ne konsiderate e axhustimeve per periudhen prarardhese ne vlera te konsiderueshme si psh shitjet e energjise me cmime tregu per mbulimin e humbjeve te OSEE sh.a. apo eksportet, etj kane per qellim percaktimin e te ardhurave te domosdoshme per zhvillimin normal te aktivitetit te furnizimit me shumice gjate vitit 2015 pa u shtremberuar nga problematikat dhe rezultatet e periudhave te meparshme. Kjo do ti sherbeje realizimit te detyrimit paresor, sigurimin e energjise elektrike per te siguruar furnizim te mjaftueshem per Furnizuesin Publik me Pakice.

KESH sh.a ne funksionin e tij si Furnizues Publik me Shumice ka paraqitur:

1. Vleresimin e tarifes se shitjes me shumice per periudhen 2012-2014.
2. Llogaritjen e kerkeses per te ardhura per vitin 2015 bazuar ne sigurimin e energjise elektrike sipas parashikimit te energjise elektrike per shitje te paraqitur nga OSHEE sh.a.

#### **2.3.1. Llogaritja e tarifes se furnizuesit Publik me Shumice per vitin 2015.**

Te ardhurat e kerkuara nga KESH sha., ne funksionin e tij si furnizues me shumice i energjise elektrike, per vitin 2015 llogariten duke marre parasysh :

- Kerkesen per blerje energjie te barabarte me ate kerkuar nga OSHEE.sha. si furnizues me pakice.
- OPEX –in per realizimin e aktivitetit te furnizimit me shumice

Tabela. “Llogaritjet e kostove dhe tarifes perkatese per Furnizuesin Publik me Shumice per vitin 2015 (milion leke):

	Aplikimi i FPSH	Propozimi ERE
	2015	2015
Blere energji nga Prodhuesi Publik	3,248	3,248
Cmimi I prodhimit te energjise elektrike - leke/kWh	1.44	1.45
<b>Kosto Totale e Prodhimit Publik-( 000 leke)</b>	<b>4,674</b>	<b>4,724</b>
Imortet e Energjise -GWh	142	142
Kosto e Importit - leke/kWh	7.17	7.17
<b>Kosto totale e importit</b>	<b>1,018</b>	<b>1,018</b>
Blerje energjie nga PVE- GWh	885	885
Cmimi I PVE - leke/kWh	9.02	6.64
<b>Kosto Totale e PVE- 000 leke</b>	<b>7,983</b>	<b>5,875</b>
Blerje energjise nga ashta	234	234
Cmimi i HEC Ashta leke/kWh	8.30	8.30
<b>Kosto Totale e HEC Ashta - leke/kWh</b>	<b>1,939</b>	<b>1,942</b>
Blerje energjie nga IPP ndare	35.5	35.5
Cmimi I PVE - leke/kWh	6.25	6.25
<b>Kosto Totale e PVE- 000 leke</b>	<b>222</b>	<b>221.9</b>
<b>Kosto Totale e Energjise -000leke</b>	<b>15,837</b>	<b>13,781</b>
Shpenzime per personelin	30	30
Materiale	2	2
Furnitura e Sherbime	9	9
Shpenzime per interesa	1,771	1,772
Kosto fikse TEC-Vlore		
<b>Totali I te Ardhurave te Kerkuara</b>	<b>17,649</b>	<b>15,594</b>
Marzhi I Fitimit ( (0.5% e te ardhurave te kerkuaraper blerjen e energjise)	79	69
axhustimi i periudhes 2012-2014	-2,031	-2,031
<b>Totali I te Ardhurave te Kerkuara-000 leke</b>	<b>15,697</b>	<b>13,632</b>
Energji e shitur	4,544	4,544
<b>Tarifa e FPSH-se leke/kWh</b>	<b>3.45</b>	<b>3.00</b>

KESH sh.a. ne funksionin e furnizuesit publik me shumice prashikon qe kerkesa e OSHEE.sh.a. per shitjet tek klientet tarifore per vitin 2015 te mbulohet si vijon: blerje e energjise elektrike nga KESH Gen per 3,248 GWh, blerje nga importi per 142 GWh, blerje energjie nga PVE per 885 GWh, blerje energjie nga HEC Ashta per sasine prej 234 GWh dhe blerje nga HEC Lanabregas per 35.5 GWh. Nisur nga analiza per treguesit e mesiperm konkludojme se blerjet e paraqitura ne aplikimin e FPSH jane te mjaftueshme per mbulimin e kerkeses per klientet tarifore.

Ne vijim praqesim propozimet ne lidhje me shpenzimet per vitin 2015 nga KESH sh.a. per aktivitetin e furnizimit me shumice te energjise elektrike:

- Shpenzimet per blerje energjie nga PVE propozohet te jene 2,108 milion leke me pak nga kerkesa e KESH (aplikuar 7,983 milion leke). Ky ndryshim vjen si rezultat i perlllogaritjes se nje cmimi te blerjes se energjise nga PVE 6.64 leke/kWh nga 9.02 leke/kWh i kerkuar nga kompania. Cmimi 6.64 leke/kWh i propozuar nga grupi i punes rezulton nga zbatimi i VKM i dates 26.11.2014, "Per disa ndryshime ne vendimin e Nr.27, date 19.1.2007, te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve" te ndryshuar. Ne kete vendim nder te tjera percaktohet se: "*Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet e dhena me koncension deri 15MW do të llogaritet çdo vit nga Enti Rregullator i Energjisë e do të shpallet prej tij në fillim të çdo viti, në bazë të formulës së mëposhtme:*


*Çmimi shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent / kWh X koeficientin 1.1 (kur është i aplikueshëm) X normën mesatare të këmbimit në euro/ lekë për vitin e fundit.*

*Me çmim mesatar të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike kuptohet çmimi mesatar vjetor, i ponderuar për produktin në bandë për vitin, për të cilin ERE do të miratojë tarifën përkatëse, siç publikohet nga bursa e Hungarisë HUPX në faqen e internetit: [www.hupx.hu](http://www.hupx.hu), më 1 dhjetor të vitit kur ERE merr vendimin për miratimin e çmimit".*

Grupi i punes i ngritur me urdher te kryetarit te ERE-s nr.90 date 12.12.2014 ne zbatim te ketyre udhezimeve te vendimit te Keshillit te Ministrave te dates 26.11.2014, te sipercituar konstatoi se:



Çmimi mesatar i bursës hungareze të energjisë elektrike për vitin 2015 sipas përcaktimit të pikës 1 paragrafi 2 i këtij vendimi, në datë 01.12.2014 është **43.12 euro/mwh** sikurse paraqitur më poshtë:



Duke marrë në konsideratë këto çmime si dhe kursin mesatar të këmblimit 140 leke/EUR për vitin 2014, rezultojnë që çmimi i shitjes së energjisë nga HEC-et e vegjël të jetë 6.64 leke/kWh për vitin 2015. Nderkohe, nisur nga udhëzimi i ministrisë së energjitikës në seancën publike të datës 5 dhjetor 2014 si dhe sugjerimet e autoritetit të Konkurrencës i cili në mënyrë të perseritur nëpërmjet komunikimeve zyrtare (vecanërisht në shkresën me nr. 524 Prot datë 10.12.2014) është shprehur që, *duhet marrë në konsideratë rekomandimi mbi përdorimin e një metodologjie të njëjtte për përlogaritjen e tarifave të prodhuesve të vegjël*, gjykojmë që ky çmim do të aplikohet edhe për HEC-et ekzistues të dhëna me konkencion para 2007.

- Shpenzimet per interesa per overdraftet dhe huate e marra nga bankat e nivelit te dyte jane pranuar ne shumen 1,771 milion leke e propozuar nga kompania. Per vitin 2015 kompania parashikon rritje te totalit te detyrimit per overdrafte kryesisht per te mbuluar importin e energjise per vitin 2015. Tabela ne vijim paraqet ecurine e levizjes se detyrimeve per linjat e kredive dhe overdrafteve :

Linjat e Kredive dhe OD-ve	Balanca me 31.12.2011	Balanca me 31.12.2012	Balanca me 31.12.2013	Balanca me 31.12.2014	Balanca me 31.12.2015
<b>Totali i Linjave te Kreditit dhe OD-ve</b>	<b>134,699,028 €</b>	<b>171,584,343 €</b>	<b>214,926,756 €</b>	<b>245,608,571 €</b>	<b>259,028,571 €</b>

Nga analiza dhe verifikimi i informacionit te vene ne dispozicion nga kompania per kete qellim konstatohet se norma mesatare e interesit per linjat e kredive eshte 4.9% ndersa ne menyre me analitike shpenzimet per interesat e overdrafteve per vitin 2015 paraqiten ne tabelen ne vijim:

Nr	Emertimi i Llogarise	Parashikimi per vitin 2015	
		Principal	Interesa
		ALL	ALL
1	Raiffeisen Bank	1,390,000,000	52,820,000
2		2,240,000,000	98,560,000
3		1,120,000,000	49,280,000
4		1,260,000,000	55,440,000
5		5,610,000,000	213,180,000
6		4,980,000,000	179,280,000
7		4,900,000,000	215,600,000.00
8	BKT	4,700,000,000	399,500,000
9	Intesa Sanpaolo Bank	-	-
10		702,000,000	33,696,000
11		702,000,000	33,696,000
12		4,200,000,000	201,600,000
13		1,000,000,000	48,000,000
14	Tirana Bank	280,000,000	17,640,000
15	Credit Agricole	705,000,000	44,415,000
16	B.S.Generale	700,000,000	29,400,000
17		840,000,000	35,280,000
18	B.Union	280,000,000	16,744,000
19	B.Credins	655,000,000	47,487,500
		<b>36,264,000,000</b>	<b>1,771,618,500</b>

- Shpenzimet operative ne total jane kerkuar nga shoqeria per shumen 42 milion leke. Propozojme qe te pranohet ky nivel shpenzimesh nisur nga fakti qe kjo kerkese eshte pothuaj e nejte me ate te miratuar per tarifen periudhes 2012-2014. Nderkohe, veme ne dukje se realizimi i ulet i ketij shpenzimi per periudhen 2012-2014 shpjegohet me situaten e veshtire financiare.
- Marzhi i fitimit i llogaritur 0.5% mbi shpenzimet per blerje energjie rezulton 69 milion leke nga 79 milion leke te kerkuara nga kompania.

- Eshte pranuar propozimi i kompanise per axhustimin ne zbritje te shumes prej 2,031 milion leke nga te ardhurat e kerkuara per vitin 2015 qe i korrespondon pjeses se te ardhurave nga shitja e energjise per humbjet e OSHEEsh.a. nga prodhimi, faturuar me 2.2 leke/kWh minus tarifen e prodhimit 1.00 leke/kWh

Duke marre ne konsiderate te gjitha korrigjimet e mesiperme, propozohet qe te ardhurat e kerkuara mesatare te FPSH per vitin 2015 te jene 13,632 milion leke dhe nderkohe tarifa mesatare per aktivitetin e furnizimit me shumice do te rezultojte **3.00 leke /kWh**.

### **3. PERCAKTIMI I TARIFES SE SHERBIMIT TE TRANSMETIMIT TE ENERGIJISE ELEKTRIKE NGA OST SH.A. PER VITIN 2015.**

Ne llogaritjen e tarifes se sherbimit te transmetimit te energjise elektrike per vitin 2015, OST sh.a mbeshtetet ne kerkesen per te ardhura te OST sh.a-se (OPEX dhe CAPEX prej 5,513 milion leke) si dhe parashikimin e energjise se levruar ne sistemin e transmetimit prej 7750 GWh per vitin 2015.

Propozimi i OST sh.a. per vitin 2015 eshte bazuar ne supozimet dhe te dhenat e meposhtme:

- Vleren e asetëve sipas kosos historike;
- Llogaritja e amortizimit sipas normave fiskale;
- Shpenzimet Operative (OPEX), jane percaktuar duke marre parasysh programin dhe realizimin e pritshem per vitin 2014
- Strukturen organizative te miratuar nga Keshilli Mbikeqyres i OST sh.a me vendimin Nr.4, date 18.10.2013 “Per miratimin e struktures se re Organizative te OST sh.a” dhe vendimin Nr.3, date 24.01.2014 “Per miratimin e struktures se re organizative te Njesive Operative”
- Libri i pagave, i miratuar nga Keshilli Mbikeqyres me vendimin Nr.16,date 30.04.2014 ku jane percaktuar pagat sipas struktures dhe kategorive
- Niveli i humbjeve te parashikuara per vitin 2015 prej 2.26%
- Kostot e humbjeve teknike ne rrjetin e transmetimit jane vleresuar me cmim te rregulluar( cmimi i prodhimit)

- Kapitali i punes 1/12 e OPEX
- Kthimi i lejuar mbi kapitalin referuar raportit te Bankes se Shqiperie per bonot e thesarit per periudhen 2012-2014
- Raporti i synuar kapital i vet dhe borxh 40% me 60%
- Energjia e levruar ne sistem ne vleren 7,750 GWh

Ne permbledhje te kerkesave te mesiperme, tarifa e kerkuar e OST sh.a per vitin 2015 eshte 0.73 leke/kWh ose 12.3% me e larte nga sa miratuar nga ERE per periudhen 2012-2014 prej 0.65 leke/kWh me vendimin nr. 146 datë 07.12.2011.

Grupi i punes ne percaktimin e te ardhurave te kerkuara per vitin 2015 eshte bazuar ne:

- Metodologjine e llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike
- Pasqyrat financiare te audituara per periudhen 2007-2013 (bashkelidhur relacionit)
- Kerkesen e paraqitur nga shoqeria ne aplikimin per tarife per vitin 2015
- Pergjigjet e pyetjeve shtese te derguara kompanise dhe pergjigjeve ne seancat degjimore teknike

### **3.1. Shpenzimet operative (OPEX)**

Në vijim le të shqyrtojmë se pari elementet e shpenzimeve operative (OPEX) te paraqitura ne tabelen si më poshtë :

#### **Shpenzimet operative OST sh.a (2012-2015)**

( milionë lekë)

Nr.	Përmbajtja	Miratimi ERE (2012-2014) - mesatare	Aplikimi nga OST për vitin 2015					Realizimi faktik I pritshëm 2012-2014 krahasuar me aplikimin 2015	Miratimi ERE 2012-2014 krahasuar me aplikimin 2015	Miratimi ERE 2012-2014 krahasuar me realizimin e pritshëm 2012-2014	Për t'u Propozuar Bordit për miratim
			2012 (Fakt)	2013 (Fakt)	2014 (Program)	2012-2014 (mesatare)	2015 (Aplikim)				
a	b	1	2	3	4	5	6			7	
1	Mirembajtje	192	79	95	110	95	150				150
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			20%	16%		36%	58%	-22%	-51%	
2	Personeli	1024	700	726	983	803	1,045				1045
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			4%	35%		6%	30%	2%	-22%	
	% ndaj totalit te OPEX	52%	49%	46%	47%		48%				
3	Blerje energji per humbjet	228	169	209	196	191	180				268
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			24%	-6%		-8%	-6%	-21%	-16%	
4	Furnitura dhe shpenzime + CBT	519	475	542	813	610	820	34%	58%	18%	820
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			14%	50%		1%	34%	58%	18%	
I	Σ OPEX	1,964	1,423	1,572	2,102	1,699	2,195				2,283
	Rritja në % kundrejt periudhes së mëparshme			10%	34%		4%	29%	12%	-13%	

### Shpenzimet për mirëmbajtje:

Kryerja e kësaj kategorie të shpenzimeve është e domosdoshme për funksionimin normal të kompanisë, në funksion të garantimit të furnizimit pa ndërprerje të rrjetit me energji elektrike, për të eliminuar difektet dhe për të paraprirë mos ndodhjes së tyre. Mirëmbajtja e linjave dhe nënstacioneve në bazë të një ndjekje dhe studimi permanent është një pjesë shumë e rëndësishme e të gjithë punës që bën kompania e transmetimit për të realizuar një veprimtari të sigurtë dhe të sukseshme gjithëvjetore për realizimin e objektivave të saj.

Në lidhje me këtë zë të rëndësishëm të shpenzimeve operative duke parë shifrat e paraqitura në tabelë mund të konstatohet lehtësisht se duke krahasuar vlerat për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, rezulton se :

- Megjithëse për periudhen 2012-2014 vlerën për këtë zë mesatarisht ERE e ka njohur në masën 192 milionë lekë, realizimi faktik ka qene me i ulet dhe konkretisht 95 milion leke.

- b) Për vitin 2013 janë shpenzuar 95 milionë lekë, ose +20% me shumë se realizimi i vitit 2012. Lidhur me kete mund të themi se eshte e pranueshme pasi shpenzimet e mirembajtjes ndikojne ne garantimin e furnizimit pa ndërprerje të rrjetit.
- c) Në programin e vitit 2014 shpenzimet për mirëmbajtje janë parashikuar në vlerën 110 milionë lekë, që është përgjithësisht një rritje e ndjeshme kundrejt realizimit të vitit 2013 prej +16%, por me një tendencë rënie.
- d) Në propozimin nga OST për vitin 2015 prej 150 milionë lekë, paraqitet një rritje kundrejt realizimit të pritshem të vitit 2014 pra +36%. Nqs do krahasonim miratimin e ERE per periudhen 2012-2014 krahasuar me realizimin e pritshem per te njejten periudhen kemi te bejme me nje mosrealizim ne masen 51%, e cila vjen si rezultat i gjendjes se veshtire financiare te kompanise si rezultat i mospagesave nga kompania e shperndarjes.

Në këto kushte, gjykojme se për vitin 2015 mund të pranohet një aplikimi I kompanise per kete ze **ne vleren 150 milionë lekë**.

### **Shpenzimet për personelin**

Shpenzimet për personelin përbëjnë pjesën më të konsiderueshme të totalit të shpenzimeve operative. Keto shpenzime zene afërsisht 48% të totalit te shpenzimeve operative per vitin 2015. Realizimi i pritshem i shpenzimeve të personelit për vitin 2014 siç mund të shihet në tabelen e mesiperme, është +35% më shumë krahasuar me faktin e vitit 2013 dhe kjo justifikohet me dy vendime të këshillit mbikqyrës te cilat kane miratuar një rritje të tillë.

Nqs do krahasonim miratimin e ERE per periudhen 2012-2014 krahasuar me realizimin e pritshem per te njejten periudhen kemi te bejme me nje mosrealizim ne masen 22%.

Meqenese fondet e aplikuesit nuk sigurohen nga Buxheti i Shtetit dhe duke pasur parasysh qe ne llogaritjet e ketij treguesi krahasuar me vitin 2014 eshte parashikuar nje rritje e shpenzimeve per paga prej 5 % ( kjo rritje synon te mbuloje inflacionin vjetor dhe ndryshimet ne kategori te punonjesve si rezultat i plotesimit te kushteve per te kaluar ne nje kategori me lart me page me te madhe) si dhe duke pasur parasysh faktet e parashtruara me lart, mendojme se për miratimin e zërit *“shpenzime për personelin”* për vitin 2015, duhen marrë në konsiderate **1,045 milion leke**.

## **Blerje energji për humbjet:**

Referuar pikes 4.1 ne modelin e tregut OST sh.a blen energji elektrike nga KESH Gen-i dhe pjesmarresit e tjere te tregut, per te mbuluar humbjet ne sistemin e transmetimit.

Përsa i përket këtij zëri të shpenzimeve, propozojme qe për vitin 2015 duhen marrë në konsideratë humbjet teknike ne rrjetin e transmetimit **ne vleren 266 milion leke**. Sqarojme se humbjet jane vleresuar me cmimin e rregulluar te prodhimit.

Po ashtu i njejte ka mbetur edhe shpenzimi i qerave te automjeteve.

Per sa shpjeguar e konsiderojme te arsyeshme shumen e kerkuar nga kompania prej 296 milion lekesh.

**“Sherbime te Koorporates”** eshte paraqitur vetem per efekt analize te OPEX-it te periudhes rregullatore 2012-2014 pasi qe prej vitit 2013 ky ze shpenzimi nuk ekziston me ne kuptimin qe ai perfaqesonte ne kushtet kur kompania ishte ne administrim te CEZ Shperndarjes. Kostot(Te ardhurat) e njohura ne tarifen 2012-2014 u parashikuan vetem per pagat e punonjesve te cilet kryenin sherbime te caktuara kontraktuale te finances etj qe me pas j'u bashkuan kompanise mesatarisht ne nivelin 312 milion leke per cdo vit te asaj periudhe.

**Shpenzimet per konsulenca, auditime & ligjore** sikurse verehet edhe ne tabelen e OPEX-it kerkohen per shumen 508 milion leke .

Ne lidhje me shpenzimet per konsulenca kompania deklaroi se Menaxhmenti i ri do t'i japë më shumë mbështetje në të ardhmen ekspertizës së brendshme , duke ulur shpenzimet për konsulencë dhe keshtu konsulenca e jashtme do të përdoret vetëm në raste të domosdoshme.

*Shpenzimet përmbartimore* janë ulur gjatë vitit 2014 dhe janë planifikuar me të njejtin trend edhe gjatë vitit 2015.

Ndikimin kryesor ne parashikimin ne rritje te ketij zeri per vitin 2015 e kane *shpenzimet ligjore* qe lidhen me programin per regjistrimin e aseteve te kompanise.

Si rrjedhim e shohim te te arsyeshme te njihet ky shpenzim ne shumen e kerkuar nga kompania prej 508 milion leke.

**Shërbime Postare dhe Komunikimi-** kjo kerkese bazohet ne kostot e pritshme per vitin 2014 si per shpenzimet postare ashtu dhe ato te telekomunikimit Shpenzimet postare lidhen kryesisht me shpërndarjen mujore të faturës për klientët dhe me tarifrat për arkëtimin e faturave nga Posta Shqiptare. Përlllogaritja e Shpenzimeve për shpërndarjen e faturës për vitin 2015 bazohet në të dhënat kostove te pritshme per vitin 2015 si me poshte:

Fatura te emetuara me lexim konsumi (Nr.)	Nr Klient	Tarife per poste	Mujore	Vjetore
		895,877	28	25,084,556

**“Kosto te tjera”:** Kerkesa per kete ze shpenzimesh eshte 1,130 milion dhe perfaqeson kosto te tjera qe kane te bejne me sigurimin e pasurise, pagesa uji, transport, taksa lokale, printim faturash, reklame & publicitet etj.

Rritja e ndjeshme e ketyre kostove ndaj miratimit per periudhen 2012-2014 shpjegohet me analizen ne vijim.

Kompania ne kete grup shpenzimesh perfshin edhe kostot e sigurise qe kane te bejne me sigurine e objekteve te tilla si nenstacione, magazinat si dhe te gjitha objektet qe i sherbejne aktivitetit te shperndarjes te cilat ne OPEX-in e miratuar per periudhen 2012-2014 jane miratuar si ze i vecante nga sa shihet edhe ne tabelat me siper duke ndikuar ne rritjen e ndjeshme te ketij grupi shpenzimesh ndaj periudhes se kaluar.

Shuma prej 242 milion leke e kerkuar per vitin 2015 eshte parashikuar me nje rritje ndaj vitit 2014 prej 50%. Nga shpjegimet e kompanise kjo nuk vjen per shkak te shtimit te nevojës per kete lloj sherbimi por per arsye te rritjes se pages mesatare te punonjesve te shoqerive te kontraktuara per ruajtjen e objekteve te kompanise cila deri me sot ka qene nen nivelin edhe te pages minimale te lejuar.

- Po ashtu nje tjeter ze me peshe ne kete kategori eshte edhe ai qe lidhet me strukturen e parashikuar te ngrihet nga kompania per uljen e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes ne shumen prej 350 milion lekesh qe gjykohet i nevojshem nga ana jone per arritjen e objektivit te uljes se humbjeve dhe emergjences per normalizimin e ketij treguesi me ndikim te drejtperdrejte ne performancen e kompanise.

Si perfundim nga sa shpjeguar me siper OPEX-i ne total prej **9,947 milion leke** (pa perfshire kostot e humbjeve ne rrjet) i kerkuar nga kompania per te dy aktivitetet Shperndarje dhe FPP mendojme te pranohet si i arsyeshem per zhvillimin normal te ketyre aktiviteteve per vitin tarifor 2015.

Per efekt te kalkulimit te te ardhurave te kerkuara per secilin aktivitet keto kosto do te ndahen midis tyre ne menyre perpjestimore bazuar ne koeficientet e pranuar te alokimit, qe jane 79.24% per shperndarjen dhe 20.76% per FPP. Ky raport i propozuar nga OSHEE bazohet ne studimin e vitit 2012 te kryer nga menaxhmenti i asaj kohe per kete qellim dhe eshte pranuar prej saj duke qene qe nuk ekziston nje baze tjeter me e pershtatshme alokimi.


Tabela ne vijim pasqyron ne menyre te permbledhur analizen e mesiperme te OPEX-it.

( milion lekë )

Nr.	Përmbajtja	Miratimi FRR (2012-2014) - mesatare	Aplikimi nga OSHEE për vitin 2015					Realizimi i priturshëm (mesatare 3 vjeçare) krahasuar me miratimin e FRR-s 2012-2014	Aplikimi 2015 krahasuar me realizimin e faktik mesatar 2012-2014	Aplikimi 2015 krahasuar me miratimin e FRR 2012-2014	Përfundim Propozuar Borëdit për miratim
			2012 (Fakt)	2013 (Fakt)	2014 (Program)	Fakt 2012-2014 (mesatare)	2015 (Aplikim)				
a	b	1	2	3	4	5	6			7	
<b>1</b>	<b>Materiale &amp; Mirëmbajtje (a+b)</b>	1 294	756	666	1082	835	3060			<b>3060</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-12%	62%		183%	-35%	267%	136%	
<b>a</b>	<b>Materiale</b>	1 232	253	308	300	287	305			<b>305</b>	
<b>b</b>	<b>Mirëmbajtje</b>	62	503	358	782	548	2755			<b>2755</b>	
<b>3</b>	<b>Personeli</b>	3613	3 252	3 121	3 356	3 243	4, 283			<b>4283</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-4%	8%		28%	-10%	32%	19%	
<b>4</b>	Post telekomunikacion	774	697	549	522	589	578			<b>578</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-21%	-5%		11%	-24%	-2%	-25%	
<b>5</b>	Sherbime korporate	312	1 276	120		465	0	0			
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-91%				49%			
<b>6</b>	Shpenzime ligjore	277	213	114	24	117	186			<b>186</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-59%	-59%			-58%	59%	-33%	
<b>7</b>	Konsulenca & auditim	245	99	37	23	53	323			<b>323</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-63%	-38%			-78%	509%	32%	
<b>8</b>	Qera	301	324	296	286	302	295			<b>295</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-9%	-3%			0%	-2%	-2%	
<b>9</b>	Teknologji e informe		16	20	29	22	30			<b>30</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)										
<b>10</b>	Kosto të tjera	553	1 354	933	580	956	1 130			<b>1 130</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-31%	-38%	0		73%	18%	104%	
<b>11</b>	Marrëdhënie me publikun		61	52	49	54	62			<b>62</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)										
<b>1</b>	<b>TOTAL OPEX</b>	<b>7,369</b>	<b>8,048</b>	<b>5,905</b>	<b>5,951</b>	<b>6,635</b>	<b>9,947</b>			<b>9,947</b>	
	Ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)			-27%	1%			-10%	50%	35%	
	<b>Penalite</b>		<b>383</b>	<b>5,415</b>	<b>2,099</b>	<b>2,099</b>					



Detajimi i te dhenave lidhur me sasine e mundur (kwh) te zvogelimit te humbjeve sipas axhensive dhe percaktimi i humbjeve (kryesisht Teknike) qe mund te pranohen per efekt te llogaritjes se tarifave te OSHEE.



Ashtu sikurse shikohet edhe ne grafik (dhe tabelen me lart) kompania me masat e mara perfshi shpenzimet per investimet, mirembajtjen dhe personelin parashikohet nje reduktim i theksuar i humbjeve i ndare sipas zonave kryesore.

Nisur nga ky nivel i pritur i humbjeve me poshte po paraqesim llogaritjet e bera per kostot e blerjes se energjise elektrike per mbulimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes.

$$\text{Sasia e levruar ne Shperndarje} = \text{Sasia e shitur ne shperndarje} / (1 - \text{perqindja e humbjeve})$$



$$(4,544 \text{ GWh} / (1 - 0,2104)) = 5,755 \text{ GWh}$$

**Sasia e energjise se humbur = Sasia e levruar ne shperndarje \* Objektiv i humbjeve (%)**

Bazuar ne tabelen e bilancit te energjise elektrike kjo sasi e energjise ne GWh per vitin 2012 eshte llogaritur si me poshte:

$$5,755 \text{ GWh} * 21.04\% = 1,211 \text{ GWh}$$

Ne kostot e mbulimit te humbjeve perfshihen edhe kostot per transmetimin e tyre te cilat jane llogaritur per kete sasi energjije dhe tarifen aktuale te transmetimit  $1211 \text{ GWh} * 0.65 = 787$  milion leke

Llogaritja e shpenzimit per blerjen e energjise per humbjat ne rrjet eshte bere mbi bazen e sasise totale per tu importuar gjate vitit 2015 prej 1,211 GWh dhe cmimit te parashikuar te importit prej 55€/MWh. Per llogaritjen ne leke te vleres se blerjes eshte zbatuar kursi i kembimit 140 leke/€ nga ku rezulton vlera prej 9324 milion leke te ciles i shtohet edhe kosto e transmetimit te energjise prej 787 milion leke.

#### **4.1.1.2. Shpenzimet Kapitale (CAPEX)**

##### **Amortizimi**

Percaktimi i vleres se amortizimit qe do te perfshihet ne llogaritjen e tarifes se sherbimit te shperndarjes se energjise per vitin 2015 bazohet ne metodologjine e llogaritjes se vleres se amortizimit per qellimin e percaktimit te tarifes se shperndarjes .

Amortizimi i shtesave te aseteteve te reja eshte llogaritur ne perputhje me metodologjine e llogaritjes se tarifes se shperndarjes pra me vleren nominale kumulative te mesit te periudhes se ciles i perkasin investimet e reja.

Ne aplikimin e saj kompania ka paraqitur amortizimin e aseteteve te vjetra (te blera para privatizimit) per vitet 2012, 2013, 2014 ne vlerat respektive 2,871 milion leke, 2,894 milion, dhe 2,781 milion leke. Per vitin 2015 kjo vlere eshte 2,415 milion leke. Amortizimi i aseteteve te reja bazohet ne shtesat e aseteteve te reja per cdo vit dhe normat perkatese te amortizimit duke rezultuar ne vlerat 536 milion leke, 642 milion leke dhe 729 milion leke perkateseisht per vitet 2012,13,14.

Per vitin 2015 vlera e amortizimit te asetëve te reja llogaritet ne shumen prej 848 milion leke e cila merr parasysh edhe shtesen e asetëve te parashikuara per vitin 2015 ne shumen prej 5,567 milion leke duke perfshire ne perlllogaritje vetem gjysmen e amortizimit vjetor qe llogaritet per kete shtese sipas metodologjise se siperpermendur.

Nga sa me siper Amortizimi total i llogaritur per vitin 2015 rezulton ne vleren **3,331 milion leke** shifer kjo e vleresuar e arsyeshme nga grupi i punes per tu perfshire ne te ardhurat e kerkuara per tarifen e shperndarjes.

### Investimet per vitin 2015

Pas shqyrtimit te planit te investimeve te OSHEE per vitin 2015 ERE vendosi te miratohet vlera e investimeve te parashikuara ne aplikimin e bere nga OSHEE dhe perfshirjen e vleres se tyre ne llogaritjet e RAB-it per vitin 2015,

**Llogaritja e RAB** dhe llogaritja e Koshtos Mesatare te Ponderuar te Kapitalit (WACC) per vitin 2015 mbeshtetet ne percaktimin e bere ne metodologjine e llogaritjes se tarifave te operatorit te shperndarjes.

Ne tabelen ne vijim paraqiten elementet perberes te formulave te llogaritjes se ketyre komponenteve.

Vlera e asetëve sipas bilancit te v.2007	16,329
Vlera e investimeve te kryera ne vitin 2008	1,954
Asete te financuara npm Grantëve	-770
Asete ndertuar nga KESH dhe transferuar ne OSSH	1,100
Vlera e investimeve te kryera per Janar-Maj 2009	3,287
Vlera e investimeve te kryera per Qershor-Dhjetor 2009	618
Vlera e investimeve qe pritet te realizohen ne v. 2010	4,681
Vlera e investimeve te miratuara per vitin 2011	2,395
vlera e investimeve per vitin 2012	766
vlera e investimeve per vitin 2013	449
vlera e investimeve per vitin 2014	1,234
vlera e investimeve per vitin 2015	2,750
minus : Amortizimi i akumuluar	-22,417
<b>Vlera e RAB v.2015 pa Kapitalin e Punes</b>	<b>12,375</b>
Kapitali i Punes	1,499
<b>RAB 2015</b>	<b>13,875</b>

### Kapitali i Punes

Kapitali i Punes per vitin 2015 llogaritet sa 1/12 e shumes se OPEX-it te kerkuar ne shumen 1,499 milion leke

## WACC

Llogaritja e kostos mesatare te ponderuar te kapitalit(WACC) nga kompania eshte paraqitur sipas formave te aplikimit , dhe Metodologjine e llogaritjes se tarifave te shperndarjes.

**Grupi i punes kerkoi informacion shtese nga CEZ Shperndarje lidhur me kostot faktike te borxheve per t'i krahasuar ato me normat e njohura ne llogaritjet e RAB te viteve 2012-2014.** Ne aplikim jane paraqitur kushtet dhe kostot shoqeruese te kredive te reja .

Ne perlllogaritjen e kostos se borxhit jane pranuar per vitin 2015 respektivisht norma e interesit te borxhit te vjeter 0.85% dhe borxhit te ri 3.35% .

Persa i perket kthimit te lejuar mbi kapitalin kompania ka perdorur normen 16.44% te njejte me ate te njohur ne periudhen e meparshme rregullatore.

<b>RAB 2015</b>	<b>13,875</b>
Norma e interesit te borxhit te vjeter	0.850%
Norma e interesit te borxhit te ri	3.353%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%
Borxhi i Vjeter - %	30.95%
Borxhi i Ri - %	29.05%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.26%
Kthim per borxhin e ri	0.97%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%
<b>WACC</b>	<b>7.81%</b>
<b>Fitimi</b>	<b>1,084</b>

*Kthimi mbi RAB*-eshte llogaritur nga ana jone konform metodologjive dhe rezulton **1,084 milion leke** per vitin 2015.

Ne perfundim propozohet, te ardhurat e kerkuara te aktivitetit te shperndarjes reduktohen edhe me te ardhurat qe parashikohen te faturohen per :

- Lidhjet e reja 399 milion leke
- Te ardhura nga energjia reaktive 253 milion leke

Ne perfundim te ardhurat kerkuara te kompanise per aktivitetin e shperndarjes pasi kemi bere ndarjen e shpenzimeve operative midis dy aktiviteteve te kompanise per vitin 2015 paraqiten ne tabelen ne vijim:

**Te Ardhurat e Kerkuara per Aktivitetin e Shperndarjes**

Zeri	2015
Kosto personeli	3,384
Post-telekomunikacion	178
Materiale	241
Riparime dhe mirembajtje	2,476
Marrdhenie me publikun dhe marketing	49
Konsulenca dhe auditime	255
Shp enzime ligjore	148
Shp enzime teknologjie e informacioni	23
sherbime korporate	
Qera	233
Kosto te tjera	897
<b>Total</b>	<b>7,883</b>
Kosto tso per humbje	787
Kosto e Humbjeve	9323
<b>Total OPEX</b>	<b>17,994</b>
Vlera e asetave sipas bilancit te v.2007	16,329
Vlera e investimeve te kryera ne vitin 2008	1,954
Asete te financuara npm Granteve	-770
Asete ndertuar nga KESH dhe transferuar ne OSSH	1,100
Vlera e investimeve te kryera per Janar-Maj 2009	3,287
Vlera e investimeve te kryera per Qershor-Dhjetor 2009	618
Vlera e investimeve qe pritet te realizohen ne v.2010	4,681
Vlera e investimeve te miratuara per vitin 2011	2,395
vlera e investimeve per vitin 2012	766
vlera e investimeve per vitin 2013	449
vlera e investimeve per vitin 2014	1,234
vlera e investimeve per vitin 2015	2,750
minus : Amortizimi i akumuluar	-22,417
Vlera e RAB v.2015 pa Kapitalin e Punes	<b>12,375</b>
Kapitali i Punes	1,499
<b>RAB 2015</b>	<b>13,875</b>
Norma e interesit te borxhit te vjeter	0.850%
Norma e interesit te borxhit te ri	3.353%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%
Borxh i Vjeter- %	30.95%
Borxh i Ri - %	29.05%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.26%
Kthim per borxhin e ri	0.97%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%
<b>WACC</b>	<b>7.81%</b>
Fitimi	<b>1,084</b>
Amortizimi i Vitit	<b>3,331</b>
Te ardhura nga Lidhjet e Reja	-399
Te ardhurat nga Energjia Reaktive	-253
<b>Totali i te Ardhurave te Kerkuara</b>	<b>21,757</b>
Energji e levruar ne rrejetin e shperndarjes	<b>4544</b>
<b>Tarifa mesatare e shperndarjes</b>	<b>4.79</b>

Ne perfundim sasia e levruar ne rrjetin e shperndarjes do te realizohet me nje tarife mesatre prej **4.79 leke/kWh**.

#### 4.1.2. Perlllogaritja e tarifes se shperndarjes per nivel tensioni

Ka qene nje detyrim i vazhdueshem per kompanine llogaritja dhe paraqitja per miratim e tarifave te shperndarjes se energjise per cdo nivel tensioni gje qe nuk eshte realizuar deri tani per arsye te pamjaftueshmerise se te dhenave te nevojshme per alokimin e kostove perkatese sic do te duhej te ishin vlerat e aseteve me te cilat lidhet ky sherbim per cdo nivel tensioni (RAB&WACC), niveli i humbjeve teknike dhe jo teknike te energjise etj.

Ne kete aplikim kompania ka paraqitur nje llogaritje qe sipas saj ka mjaft rezerva per shkak te pasigurise se shume prej te dhenave te perdorura si baze. I vetmi faktor alokimi i perdorur ka qene raporti i sasise se energjise se parashikuar te shitjes ne cdo nivel tensioni ndaj sasise totale te shitjes sipas struktures se shitjes te vitit 2013 i kombinuar me nivelin e humbjeve teknike per cdo nivel tensioni .

Koeficientet e aplikuar per alokimin e zerave te OPEX-it dhe CAPEX-it te shperndarjes sipas niveleve te tensionit te propozuar nga OSHEE jepen ne tabelat ne vijim:

#### Sasia e energjise shltur sipas strukures se shitjes sw vitit 2013

Niveli i tensionit	Viti 2013	%	Humbje per nivel tensioni	Raporti i humbjes
	KWH			%
35 kV	35,763	0.91%	1,609	0.42%
20 kV	271,881	6.89%	8,156	2.12%
10 - 6 kV	503,670	12.77%	45,330	11.77%
Tension I ulet	3,132,108	79.43%	330,124	85.70%
Total	3,943,422	100.00%	385,220	100.00%

#### Humbja teknike

Tensioni	Humbje%
35kV	4.50%
20kV	3.00%
10-6 kV	9.00%
0.4 kV	10.54%
<b>Total</b>	<b>21.04%</b>

Si me siper shpjeguar per alokimin e OPEX-it per cdo nivel tensioni eshte perdorur pesha specifike e shitjes se energjise elektrike sipas struktures se shitjes qe sic tregohen ne tabele jane 0.91%, 6.89%, 12.77% dhe 79.43% respektivisht per nivelet e tensionit 35kV,20kV,10-6 kV,TU.

Me keta koeficiente eshte bere edhe alokimi i vleres se aseteteve, RAB-it ,kapitalit te punes dhe WACC.

Alokimi i kostos se humbjeve eshte bere mbi bazen e koeficienteve te raportit te humbjeve per nivelin perkates te tensionit qe jane 0.42%,2.12%,11.77%,85.77% per nivelet e tensionit 35kV,20kV,10-6kV,TU.

Si rezultat tarifat e propozuara te shperndarjes per vitin 2015 (transmetimit ne rrjetin shperndares) sipas niveleve te tensionit jane si me poshte:

Per nivelin e tensionit 35 kV	tarifa e propozuar eshte 3.64 leke/kWh
Per nivelin e tensionit 20 kV	tarifa 3.32leke/kWh
Per nivelin 10-6 kv	tarifa 4.59 leke /kWh
Per TU	propozohet tarifa 4.91 leke/kW

Ne lidhje me aplikimin e kompanise shikojme se keto tarifa jane shume te larta sepse perfshijne shpenzime te cilat jane te paaesyetuara per grupin e konsumatoreve qe konsumojne ne tensionin e mesem dhe sidomos ne nivelin 35KV dhe 20KV. Konsumatoret e lidhur ne keto nivele tensioni jane lehtesisht te evidentueshem, te kontrollueshem dhe te matshem me nje saktesi shume me te madhe se ata te lidhur ne tension te ulet. Per me teper perqindja e humbjeve te perdorur eshte shume me e larte se ajo e parashikuar nga Studimi i Humbjeve Teknike te kryer nga PWC (Price WaterHouse Cooper) ne vitin 2010.

Ne pamundesi per te mare te dhena me te sakta nga kompania per percaktimin e tarifes se aksesit ne tensionin e mesem ERE i eshte referuar edhe ketyre tarifave ne rajon si me poshte:

- Ne Kosove, Rregullatori i Energjise ka aprovuar per vitin 2014 tarifat: 1.12 Euro cent/KWh per nivelin 35KV; 1.28 Euro cent/KWh per nivelin 10KV dhe 2.07 Euro Cent/KWh per nivelin 0.4KV.

- Ne Serbi, rregullatori i Energjise ka aprovuar keto tarifa aksesit: 1.4 RSD/KWh (1.1 Eurocent/KWh) per nivelin 35 KV; 1.5 RSD/KWh (1.2 Eurocent/KWh)per nivelin 10KV.

Ne vendimin nr. 20 date 14.02.2008, ERE ka aprovuar per here te pare tarifat e aksesit, per perdorimin e rrjetit te shperndarjes per te dy nivele tensioni, 35KV dhe 20/10/6 KV si me poshte:

- 2 leke/KWh ne nivelin 35KV
- 2.6 leke/KWh ne nivelin 20/10/6 KV

Se fundmi: per percaktimin e tarifes se aksesit per nivele tensioni po paraqesim llogaritjet tona. Per keto llogaritje jane perdorur supozimet ne vijim:

- Per shperndarjen e kosos se kapitalit (te ardhurat nga RAB dhe Amortizimi vjetor) dhe korrigjimet per te ardhurat nga lidhjet e reja jane perdorur raportet e alokimit sipas vleres se aseteve per nivelet perkatese te tensionit. *Per percaktimin e ketyre raporteve eshte gjykuar qe asetet e tensioneve me te larta sherbejne edhe per furnizimin e klienteve te lidhur ne tensionet me te uleta.*

Raportet e aseteve	Vlera e mbetur e Aseteve dt 31.5.2014 (leke)	Vlera e aseteve sipas perdorimit (leke)	Raportet e alokimit sipas aseteve
TL	166,973,643	-	0.00%
TM 35kv	147,091,084	3,077,834	0.01%
TM 20/10/6kv	11,302,991,487	2,276,188,595	10.50%
TU	10,052,479,310	19,390,269,094	89.48%
Total	<b>21,669,535,524</b>	21,669,535,524	100.00%

- Per shperndarjen e shpenzimeve operative (OPEX) dhe korrigjimeve per energjine reaktive jane perdorur raportet e energjise per tu konsumuar ne cdo nivel tensioni sipas struktures se shitjes se propozuar nga OSHEE sh.a. ndaj totalit te energjise .
- Per shperndarjen e kosos se humbjeve eshte konsideruar niveli prej 21.04% i humbjeve (sipas spjegimeve me lart). Gjithashtu, eshte konsideruar edhe studimi i humbjeve te kryer nga kompania audituese Price Waterhouse Cooper ne Qershor 2010 per percaktimin e hmbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes

Nderkohe, është përdorur arsyetimi se një pjesë e humbjeve të shkaktuara në nivelet e mesiperme të tensionit i takojnë konsumit të energjisë në tensionet në vijim. Për këto qëllim janë shfrytëzuar raportet e konsumit të energjisë në çdo nivel tensioni ndaj totalit të energjisë.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur llogaritjet dhe rezultatet për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë sipas niveleve të tensionit.

<b>Te Ardhurat e kerkuara per 2015</b>	<b>Njesia</b>	<b>35KV</b>	<b>Total</b>
Raportet e alokimit sipas asetëve	%	0.014%	100.00%
Raportet e alokimit sipas energjisë sipas konsumit	%	0.980%	100.00%
Raportet e alokimit sipas humbjeve	%	0.009%	100.00%
Te ardhura mesatare nga RAB	mil leke	0.15	1084
Te ardhura mesatare nga Amortizimi	mil leke	0.47	3331
OPEX	mil leke	77.25	7883
Kosto e humbjeve (2012-2014)	mil leke	0.87	10110
Te ardhura te tjera (lidhjet e reja)	mil leke	-	-399
Te ardhura te tjera (tarif zero)	mil leke		0
Te ardhura te tjera (reaktive)	mil leke	(11.03)	-253
Total i te ardhurave mesatare te kerkuara	mil leke	68	21756
Energjia e shpërndare	GWh	45	4544
<b>Tarifa mesatare</b>	<b>Leke/kWh</b>	<b>1.5</b>	<b>4.8</b>

Duke konsideruar nevojën aktuale për liberalizimin e tregut, e cila është shprehur edhe në letren e MEI dërguar në ERE, ku konsiderohet e rëndësishme strukturimi i tarifave të cilat të bazohen në kostot reale, propozojmë që të aplikohen tarifën e aksesit si më poshtë:

- 1.5 - leke/KWh për nivelin 35KV
- Për tarifën e aksesit për nivelet e tjera të tensionit propozojmë të bëhet në një kohë të dytë, brenda vitit 2015, duke u nisur nga fakti se kompania do të arrijë të evidentojë asetet sipas nivelit të tensionit si dhe nivelin e humbjeve.



#### 4.2. TARIFA E SHERBIMIT TE FURNIZIMIT ME PAKICE (FPP) TE ENERGIJISE ELEKTRIKE PER VITIN -2015

Te ardhurat e kerkuara per realizimin e aktivitetit te furnizimit me pakice sherbejne per te mbuluar te gjithe kostot e transferueshme te aktiviteti te gjenerimit , furnizimit me swhumice, transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit me pakice te energjise elektrike.

Ne menyre te permbledhur shpenzimet qe lidhen me keto veprimtari jane paraqitur ne Tabelen ne vijim:

**Tabela Ilogaritese e cmimit te shitjes me pakice**

Zeri	2015
Kosto Personeli	899
Post-Telekomunikacion	400
Materiale	64
Riparime dhe mirembajtje	279
Konsulence dhe auditime	68
Shpenzime teknologjie dhe informacioni	6
Shpenzime ligjore	39
Marrdhenie me publikun	13
Qera	62
Te tjera	238
<b>Total OPEX</b>	<b>2,069</b>
Tarifa e blerjes se energjise nga FPSH Lek/KWH	3.00
Blerjet e energjise nga FPSH- GWH	4,544
Kosto totale e blerjes se energjise nga FPSH - Lek 000s	13,632
Norma e fitimit te FPP (%)	2.20%
<b>Fitimi</b>	<b>300</b>
Kerkesa per te ardhura e OST	2,954
Kerkesa per te ardhura e OSSH	21,757
Shpenzime Borxhi te Keq	4,497
Shuma vjetore per shlyerje detyrimi ndaj CEZ (Nga marreveshja qeveritare)	3,433
<b>Te Ardhurat e Kerkuara Totale te FPP</b>	<b>48,641</b>
Shitjet e energjise	<b>4,544</b>
<b>Cmimi mesatar per konsumatorin tarifore</b>	<b>10.70</b>
	<b>12.3%</b>

Sic verehet keto te ardhura perbehen nga :

1. Totali i OPEX-it kerkuar per aktivitetin e FPP eshte per vleren 2,069 milion leke dhe sic permendet me siper kjo shifer eshte rezultat i perdorimit te koeficientit te alokimit prej 20.76% ndaj totalit te OPEX-it.
2. Kosto totale e blerjes se energjise elektrike per shumen 13,632 milion leke

3. Kosto totale e transmetimit te energjise elektrike per shumen 2,954 milion leke
4. Kosto totale e shperndarjes se energjise elektrike per shumen 21,757milion leke.
5. Detyrimi per shlyerje ndaj CEZ Shperndarje” ne shumen prej 3,433 milion leke qe i referohet detyrimit qe rrjedh nga Marreveshja mes Qeverise Shqiptare dhe CEZ Shperndarje.

Ne kerkesen e saj kompania ka perlllogaritur Borxhin e Keq ne shumen 4,497 milion leke i cili rezulton nga zbatimi i nivelit 11.85 % te mosarketimit ndaj te ardhurave te pergjithshme te kerkuara te kompanise, pra te ardhurat nga shitja te parashikuara per vitin 2015. Percaktimin e nivelit te mosarketimeve per efekt te kalkulimit te shpenzimit ne kerkesen per te ardhura te FPP kompania e argumenton te bazuar ne:

- gjendjen e tyre per kategorite e konsumatoreve Familjare, Privatet dhe Jo Buxhetoret duke perjashtuar ne llogaritje konsumatoret buxhetore per arsyen se keta jane institucionet buxhetore dhe mbeshteten nga shteti per shpenzimet e tyre.
- ne gjendjen reale te mosarketimeve dhe trendin e ketij treguesi per vitet 2012, 2013, 10 mujorit Janar-Tetor 2014 dhe te dhenave te muajve me te fundit *i cili ka qene ne permiresim te ndjeshem* si rezultat i angazhimit me te madh te kompanise ne kete drejtim .
- ne rezultatet e studimit te kryer nga kompania audituese Deloitte mbi Llogaritjen e Borxhit te Keq te Operatorit te Shperndarjes.

Sa me siper duket qe keta faktore konvergojne ne nivelin e kerkuar nga kompania prandaj grupi punes propozon te njihet niveli prej 11.85% per efekt te llogaritjes se shpenzimit te Borxhit te Keq ne te ardhurat e FPP per vitin 2015.

Si konkluzion propozojme qe per vitin 2015 kompanise OSHEE sh.a t’i njihen te ardhurat e kerkuara per aktivitetet e furnizimit me pakice shuma prej **48,641** milion Leke, qe i korrespondon nje tarife msatare te shitjes se energjise elektrike prej **10.7 leke/kWh**, me nje rritje prej 12.28% me ate te miratuar nga ERE ne vendimin nr. 148 date 7.12.2011 dhe **7.76 %** me e larte se sa cmimi mesatar aktual i realizuar nga shitja e energjise elektrike per te gjithë konsumatorët tarifore ;

## **Ne lidhje me struktura e tarifave ne aplikim e saj kompania deklarone se ;**

- a) Përfshirja e komponentit fiks tarifor duke pasur parasysh pagesën për fuqi të instaluar bazuar në praktikat dhe standartet europiane dhe botërore do të ishte një ndihmesë shumë e madhe në përmirësimin e menaxhimit të kompanisë duke ndihmuar njëkohësisht rritjen e transparencës për publikun.
- b) Kompania nuk e quan të arsyeshme ndarjen e klientëve sipas llojit të tyre si klientë për industri, bujqësi, tregëti e shërbime, prodhime mielli e buke, buxhetore, familjarë etj dhe llogaritjen e tarifave të veçanta për secilin prej tyre.
- c) Kompania mendon se edhe shpërndarja me fasha e shitjes së energjisë elektrike për konsumatorët familjarë duke përdorur kompaninë dhe shitjen e energjisë si një element për zbatimin e politikave shtetërore në zbutjen e varfërisë, duhet të hiqet. Shteti mund dhe duhet të gjejë elementë të tjerë të drejtpërdrejtë për të rimbursuar shtresat në nevojë. Për kompaninë kjo sjell kosto të panevojshme të cilat do të tentonin uljen e tarifës të energjisë elektrike dhe jo rritjen e tij. Kompania ne aplikim e saj dhe ne vazhdimësi me informacionet shtese qe i ka derguar ne ERE kerkon qe per konsumatorët familjare te zbatohet cmimi unik prej **9.5** leke/KWh

## **Ne lidhje me Tarifen e konsumatoreve familjare me dy blloqe konsumi sqarojme se,**

Vendimi i EREs(Vendimi nr. 21. )per vendosjen e tarifës me dy blloqe është marrë ne 14.02.2008, Duhet sqaruar se ky vendim i EREs nuk pati për qëllim mbrojtjen e shtresave në nevojë, e cila nuk është përgjegjësi ligjore e EREs, por është projektuar si një masë e efikasitetit për energjinë. Me fjalë të tjera vendosja e tarifave me blloqe kishte si qëllim dekurajimin e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje dhe konsumatorët të drjetohehin burimeve të tjera të energjisë për këtë qëllim.

Nga historiku i konsumit të energjisë nga konsumatorët familjare që nga viti 2008, ERE verë:

- Vështirësi në faturim dhe në menaxhimin e sistemit të billingut,
- Aplikimi i tarifës me dy blloqe ka rritur abuzimin nga ana e kompanisë duke çuar në rritjen e numrit të ankesave nga familjarët për faturat e energjisë elektrike, të cilat mesatarisht janë rreth 50 000 cdo vit.
- Gjithashtu ekzistenca e fashave ka pasur ndikim të ndjeshëm në rritjen e nivelit të humbjeve joteknike të kompanisë. Kjo verëhet qartë edhe nga

trendi i humbjeve joteknike per vitiet 2011-2013 te cilat kane qene vazhdimisht ne rritje.

Duke u nisur nga sa me siper tarifa me blloqe konsumi e projektuar si nje mase eficence nuk funksionoi si e tille. Per me teper krijoi probleme per kompanine dhe gjithashtu per konsumatore familjare. ERE mendon se:

- heqja e tarifes me blloqe konsumi do te lehtesonte faturimin nga ana e kompanise
- do te reduktonte kostot panevojshme te leximit dhe faturimit ne kohe shume te shkurter.
- do te permiresonte edhe sherbimin per konsumatore ne lidhje me saktesine e faturimit.
- Do te ule ne minimum mundesine e abuzimit.
- Do te eliminoje ndersubvencionin brenda grupit duke eliminuar diskriminimin.

Duke u nisur nga arsyetimi i mesiper ERE e quan te drejte kerkesen e kompanise per heqjen e tarifes me dy blloqe konsumi dhe aplikimin e nje tarife unike

Ne perfundim duke reflektuar te gjithe llogaritjet e te ardhurave te kerkuara dhe alokimin e tyre sipas nivelit te tensionit i propozojme Bordit te Komisionereve , Strukturen e cmimeve te shitjes me pakice te furnizimit te energjise elektrike per konsumatore tarifore te jete :

<b>Tarifat e sherbimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2015</b>		
<b>Niveli i tensionit</b>	<b>Cmimi (leke/kWh)</b>	<b>Cmimi pik (leke/kWh)</b>
<b>Konsumatore ne 35 k V</b>	<b>9.5</b>	<b>10.93</b>
<b>Konsumatore ne 20/10/6 kV</b>	<b>11</b>	<b>12.65</b>
<b>Furra buke dhe prodhim mielli ne 20/10/6 kV</b>	<b>7.1</b>	<b>8.17</b>
<b>Konsumatore ne 0,4 kV</b>	<b>14</b>	<b>16.1</b>
<b>Furra buke dhe prodhim mielli ne 0,4 kV</b>	<b>7.6</b>	<b>8.74</b>
<b>Familjare</b>	<b>9.5</b>	
<b>Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (ndricim shkalle, pompe,ashensor)</b>	<b>9.5</b>	
<b>Tarife fikse e sherbimit per leximin "zero" (leke/muaj)</b>		<b>200</b>
<i>*Cmimi i energjise reaktive eshte sa 15 % e cmimit te energjise aktive</i>		
<i>* Orari pik gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik eshte :</i>		
<i>Per periudhen 1 Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri ne 22:00</i>		
<i>Per periudhen 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23 : 00</i>		

Energjia ne oret e pikut te jete e pandryshuar , 15 % me e larte se sa cmimi i energjise elektrike te furnizuar ne baze

Ne perfundim mendojme se ndertimi i nje strukture te re tarifore do te motivoje nje performance me te mire te kompanive te rregulluara si dhe do te siguroje te ardhura te mjaftueshme per nje operim normal, sipa parimit qe kostot te mbulohen nga cdo kategori konsumatoresh, ne raport me kostot e sherbimit te kesaj kategorie.

### ***5. MBI RISHIKIMIN E CMIMIT TE SHITJES SE ENERGIJISE ELEKTRIKE PER HEC-ET EKZISTUES DHE HEC-ET E RINJ ME FUQI TE INSTALUAR 15 MW PER VITIN 2013 DHE 2014.***

Vendimi nr. 161 date 07.12.2012 si dhe Vendimi nr. 54 datë 03.05.2013, e më pas Vendimi nr. 149 datë 24.12.2013 vendosen të lënë në fuqi perkatesisht deri ne date 31 dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2014 tarifat e miratuara me vendimet nr. 144,146, 147,148, 149, 150, 151, 153, datë 07.12.2011 si dhe vendimin nr. 87, datë 29.06.2012, “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Keto vendime percaktojne se kompesimi i të gjitha efekteve financiare për operatorët e rregulluar do të kryhet brenda të njëjtës periudhë rregullore 2012-2014, apo në periudhën rregullore pasardhës. Vecanerisht pika 3 e vendimit nr. 149 date 24.12.2013 shprehet qarte per “perditesimin dhe kompensimin e të gjithë efekteve financiare brenda të njëjtës periudhë rregullore 2012 - 2014, apo për periudhën rregullore pasardhëse, të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe ato ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW”.

Per sa parashtruar me siper, rrillogaritjet e cmimeve te shitjes se energjise elektrike hidrocentralet dhe ato ekzistues me fuqi të instaluar deri në 15 MW per vitet 2013 dhe 2014 paraqiten si vijon.

### 5.1 Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et ekzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et ekzistues eshte zbatuar “Metodologjine per llogaritjen e cmimit te unifikuar per shitjen e energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise nga HEC-et me fuqi te instaluar deri 10 ne MW” te miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr.5, date 26.01.2007. Ne zbatim te kesaj metodologjie, per llogaritjen e cmimit te shitjes se energjise elektrike do te perdoret formula ne vijim:

$$P_U = (P_R - P_T) * (1 - L_D \%)$$

Ku:

- $P_u$  Cmimi unik i prodhuesve me fuqi deri 10 ne MW,
- $P_r$  Cmimi mesatar i shitjes me pakice te energjise elektrike te klientet tarifore ne shperndarje per vitin 2013, i cili sipas vendimeve te mesiperme eshte i pandryshuar 9.53 leke/KWh per periudhen rregullatore 2012-2014.
- $P_t$  Tarifa e sherbimit te transmetimit e cila ne zbatim te vendimeve te sipercituara eshte e pa ndryshuar pra te miratuar 0.65 leke/kWh per periudhen 2012-2014
- $L_D \%$  Perqindja e humbjeve teknike ne rrjetin e shperndarjes e pranuar nga ERE per efekt te llogaritjes se cmimit unik sipas kesaj formule. Sipas raportimit periodik te muajit tetor nga CEZ Shperndarje derguar me shkresen Nr.6091/10 Date 24.01.2013 humbjet teknike ne shperndarje per periudhen janar-dhjetor 2012 jane ne nivelin 15.2 % ndersa nga raporti i CEZ Shperndarje per vitin 2013 paraqiten po ne te njejtin nivel si viti i meparshem, pra ne nivelin 15.2%

$$P_U = (9.53 - 0.65) * (1 - 0.152) = 7.53 \text{ leke/kWh}$$

Shenim: Treguesi i humbjeve teknike ne shperndarje per vitin 2011 i raportuar nga CEZ derguar me shkresen Nr.626 date 27.10.2011 per periudhen janar-tetor 2011 ishte ne nivelin 12.82 %. Ky nivel i humbjeve u konsiderua ne

llogaritjen e tarifave te shitjes se energjise elektrike per kete kategori gjeneruesish per periudhen 2012-2014.

Sa me siper, çmimi i rishikuar i shitjes se energjise elektrike nga HEC-et ekzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW eshte i njejte 7.53 leke/kWh per te dy vitet 2013 dhe 2014.

## *5.2 Cmimi i shitjes se energjise elektrike per HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW.*

Per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri 15 MW eshte zbatuar "Metodologjine per percaktimin e çmimit unik te energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW te dhene me koncension ne baze te Ligjit Nr. 9663, date 18.12.2006 "Per Koncensionet" " metodologji e miratuar nga Bordi i Komisionereve te ERE-s me vendimin Nr. 24, date 11.04.2007. Sipas metodologjise se siperpermendur, per llogaritjen e çmimit te shitjes se energjise elektrike do te perdoret formula ne vijim:

$$P_u = P_i * 1.1 * R_{EX}$$

Ku :

$P_u$  Cmimi unik i energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW,

$P_i$  Cmimi mesatar i ponderuar i importit te energjise elektrike te realizuar nga KESH sh.a. ne vitin parardhes. Theksojme se ne momentin e hartimit te metodologjise se siperpermendur sistemi elektroenergjitik ishte vertikalisht i integruar dhe importi kryhej vetem nga KESH. Aktualisht, importi i energjise kryhet nga KESH sh.a. dhe CEZ Shperndarje sh.a., per pasoje ne vijim paraqesim çmimin mesatar i ponderuar te importeve te KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. Sipas te dhenave te raportuara nga kompanite dhe te publikuara ne raportet vjetore mbi shpenzimet faktike te KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a per importin e energjise elektrike ne vitet 2012 dhe 2013 rezulton se çmim mesatar i ponderuar i importit eshte perkatesisht 63.63 €/MWh dhe 51.51 €/MWh

1.1 Koeficient, bonusu qe u jepet te licensuarve per prodhimin e energjise elektrike nga keta HEC-e.

$R_{EX}$  Norma mesatare e shkembimit Leke/EUR te publikuar nga Banka e Shqiperise per vitin parardhes. Nga perpunimi i informacionit te publikuar nga Banka e Shqiperise mbi kursin e kembimit Leke/EUR ne cdo dite te viteve 2012 dhe 2013 rezulton se kursi mesatar per keto vite ka qene respektivisht 139.04 Leke/EUR dhe 140.26 Leke/EUR.

Viti 2013

$$P_u = 63.63 / 1000 * 1.1 * 139.04 = 9.732 \text{ leke /kWh}$$

Viti 2014

$$P_u = 51.51 / 1000 * 1.1 * 140.26 = 7.95 \text{ leke /kWh}$$

Nisur nga treguesit e percakuar si me lart rezulton nje cmim prej 9.73 leke/kWh per vitin 2013 dhe 7.95 leke/kWh per vitin 2014.

Tabela ne vijim paraqet ne menyre te permbledhur sa paraqitem me lart ne lidhje me cmimet ekzistuese dhe rrillogaritjet:

	2013		2014	
	HEC-et ekzistuese me fuqi deri 10 MW	HEC-et e rinj me koncension deri 15 MW	HEC-et ekzistuese me fuqi deri 10 MW	HEC-et e rinj me koncension deri 15 MW
Cmimi 2012-2014 (Leke/kWh)	7.77	9.30	7.77	9.30
Cmimi rrillogaritur (Leke/kWh)	7.53	9.73	7.53	7.95

Mbeshtetur ne sa me siper, propozohet qe:

- Çmimi i shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga te licensuarit konçesionare dhe private, me fuqi te instaluar deri ne 10 MW, per vite 2013 e 2014 te jete **7.53 leke/kWh**.
- Çmimi i shitjes se energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW nga te licensuarit konçesionare dhe private per vitin 2013 te jete **9.73 leke/kWh** dhe per vitin 2014 te jete **7.95 leke/kWh**.



Punuan : Lavdie Konjari, Enton Shahaj, Elida Mata, Doris Carcani, Erind Kraja,  
Julia Guga

Kunderfirmoi : Raimonda Islamaj, Agim Nashi, Eduard Elezi, Erjola Sadushi